

**PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER
AKTIVITETIN THERTORE**



SUBJEKTI TONA ALB

**VENDNDODHJA KORÇË
RRUGA FRIGORIFERI NR.2
INVESTITOR TONA ALB**

Shoqeria “TONA ALB” Sh.p.k aplikon per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B, per impiante dhe instalime te reja, referuar VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” te Ligjit Nr. 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit” Shtojca 1 (e ndryshuar) **“Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarive te lidhura me to, ID 7.7, Veprimtaria:**

7.7 a.Thertore

Vendndodhja: Objekti ndodhet ne zone industriale. Siperfaqe totale 7639m²; Siperfaqe trualli 7639m²; Siperfaqe ndertese 3125m²; Kufizimet: V: 5/637; 5/353; 5/380; 5/299; L-5/177; 5/197; J: 5/637; P: 5/637; 5/631; 5/632; 5/635.

Ne kete objekt kryhet theria e bagetive si vica derra dhe te imeta largimi i kockave nga mishi, ndarja anatomike e mishit, paketimi ne gjendje te fresket dhe te ngrire.

Pikat	X	Y
1	4499686.45	4480303.21
2	4499770.10	4480250.26
3	4499719.66	4480176.14
4	4499640.62	4480243.03
5(puseta shkarkimit ujrave	4499733.37	4480208.52



Sipas teknologjise se perzgjedhur, jane realizuar zgjidhje teknike qe sigurojne nivel te larte efikasiteti si dhe funksjonaliteti. Impianti ne te tere sektoret e tije eshte pozicionuar ne mynyre te tille qe te lejoje nje rrjedhje te personelit dhe produkteve te perpunuara qe plotesojne normat sa sanitare aq dhe racionale.

I gjithë impianti është projektuar dhe zbatuar qe te percjelle te gjitha mbeturinat e perpunimit ne zonen e caktuar per ti drejtuar ato ne pjeset e pista te sistemit per ngarkimin dhe shkarkimin nga thertorja ne kohen me te shkurter te mundeshme.

Te gjitha paisjet kryesore dhe ndihmese jane te realizuara me material inoksidabel. Temperatuara e ujit qe perdoret per larje te paisjeve eshte 82°C. Sharrat e perdorura per prerjen e mishit dhe paisjet e perdorura per mbylljen e ezofagut rektumit dhe pjeses anale, jane te paisur me stabilizatore qe furnizohen me uje ne temperature 82°C.

Larja dhe sterilizimi behet me anen e stacioneve fikse te vendosura ne pika te ndryshme te impiantit.

Ne impiantin e thertores jane te punesuar 151 punonjes. Impianti eshte instaluar ne siperfaqen e tokes ne pronesi te administratores te subjektit.

Proçesi i prodhimit .

IMPIANTI I PRODHIMIT

Impianti eshte i perbere nga nje ndertese qendrore te realizuar me beton te armuar dhe ka nje siperfaqe te mbuluar prej rreth 4000 m² te lidhur me koridore dhe vend pushime per kafshet gjate proçesit te therjes. Siperfaqe prej 8700m² sherben si ambient per levizjen e lehte te kamioneve qe transportojne kafshet e gjalla si dhe parkimin e makinave.

Ambienti i jashtem

Ambienti jashtem eshte i rrethuar.

E gjithë siperfaqja qe rrethon strukturat e prodhimit eshte ne kushte te mira, e rregulluar per te minimizuar burimet e mundeshme te ndotjes nga ambienti i jashtem.

Jane dy platforma per larjen e automjeteve, ambiente per ruajtien e plehut te permbajties se zorreve dhe jashteqitjes se kafsheve.

Ne nje ambient te veçante eshte vendosur kabina elektrike si dhe depuratori i ujit.

Brenda impiantit ndodhet thertorja per therjen e viçave, derrave dhe bagetive te imeta. Gjithashtu ndodhet dhoma frigoriferike, prerjes dhe paketimit, ambienti ngarkimit dhe shkarkimit te mishit dhe nje numur dhomash per produktet ndihmese si dhe zyrat dhe dhomat per personelin.

Zinxhiri i therjes nga zona e bagetise eshte i mbeshtetur ne trare çeliku te galvanizuar te vendosur mbi mure. Udhezuesi hekurudhore eshte realizuar me material te forte inoxidabel me dy lloje anti dalje nga shinat.



Linja eshte e perbere nga stalla, djepi therjes, ngritesin, vaska per gjake derdhje, transferimin e trupave te bagetive te therura, ngritesin e kokave, rjepsin e lekurave, rripi transportierit, heqja e te brendeshmeve. Sipas projektit te realizuar, jane bere ndarjet e dukeshme ne zonen e perpunimit midis zones se piste dhe asaj te paster.

Nderkohe jane realizuar magazinat specifike qe sherbejne per magazinimin e brireve, thundrave, zorreve, zona pastrimit per te brendeshmet, vend per larjen e veglave te punes, nje laborator lokal per monitorimin e shendetit te punonjesve.

Linja e therjes dhe ajo e te brendeshmeve konvergjon me nje koridor per veprimet e peshimit.

Trupat e bagetive te therura pasi peshohen kalohen ne nje tunel ku realizohet nje ftohje e shpejte dhe me pas kalohen ne dhomen e magazinimit. Prane, jane hapesirat te destinuar per ngarkim dhe nje zone per heqien e kockave.

Nje ambient i veçuar sherben per reduktimin e trupave te bagetive te therura ne mes si dhe per prerjen e kolones vertebrale per bagetite mbi 30 muaj.

Operacionet e ngarkim shkarkimit te varur realizohen nepermjet nje krahu te levizshem, platformes hidraulike duke perdorur nje portal izotermik te perbere nga nje izolues ne tampon dhe nje dere sektoriale me nje ndalues per gazrat e automjeteve.

Lidhur me dhomen frigoriferike ndodhet dhoma e heqes se kockave nga mishi si dhe paketimin e mishit te prere.

Nepermjet nje hekurudhe qe funksjonon nga lart, tavolines se heqes se kockave, tavolines rrotulluese dhe shiritit transportues kalohet ne ambientet e paketimit dhe me teje ne dhomen e magazinimit te mishit te fresket.

Pjesa qe perdoret per perpunimin e mishit, mbyllet me zonen e magazinimit te kockave dhe yndyres qe largohet gjate paketimit, si dhe nje dhome larje dhe ruajtje te veglave dhe paisjet te punes.

Brenda impiantit jane ambientet per stafin punonjes te ndara sipas llojeve te punes.

Ne funksjon te plote te impiantit jane dhe mjetet e transportit te bagetive, ato te transportit te mishit, dhoma e ftohjes qendrore si dhe kaldaja.

TEKNOLLOGJIA

Sistemet teknologjike jane ne funksjon te sherbimeve teknike ne nevojte per funksjonimin e duhur. Ne keto sherbime futen dhe sherbimet hidraulike si dhe ato per dizifektimin e paisjeve dhe dhe ngrohjen e ujit.

Impiantet termike te energjise perbehen nga nje gjenerator me uje te nxehte, nje depozite ngrohje per uje te ngrohete ne zyra dhe tualete, nje exchanger ngrohje per ngrohjen e dhomave, nje exchanger ngrohje per kushtet kontrolluese te larjes me presjon te larte, etj.

Tubot shperndares jane material inox dhe çelik i galvanizuar per te tre tippet e ujrave, ate te nxehtin, te ngrohtin dhe ujin e ftohet.

Centrali ngrohes ushqehet me uji te rrjetit i cili furnizon ne mynyre te pa nderprere sistemin.

Ne drejtim te shfrytezimit te mundesive te krijuara, ngrohtesia qe çlirohet gjate shkarkimeve te kompresorit gjithashtu shfrytezohet per ngrohje te ujit qe furnizon impiantin termik.

SISTEMI FURNIZIMIT ME ENERGI ELEKTRIKE

Ky sistem psembledh nenstacionin elektrik si dhe transformatorin. Nga kabina e furnizimit me energji elektrike ka nje panel te veçante te vendosur ne afersi te impiantit. Gjithashtu brenda impiantit jane vendosur panele qe dergojne energjine ne sektore te ndryshem te prodhimit.

Per çdo rast anomalie ne furnizimin me energji elektrike, nga ana e administratoreve jane marre masa per vendosjen e nje gjeneratori avarie.

Te gjithë instalimet jane realizuar ne perputhje me standartet per sigurine e instalimeve dhe parandalimin e aksidenteve.

SISTEMI FTOHJES

Sistemi ftohjes perbehet nga njesite ftohese, tubacionet e shperndarjes se agentit ftohes si dhe paisjet e perdorura per njesite e kondensimit. Ne njesine e ftohjes eshte montuar nje kompresor gjysem hermetik reciprok per furnizimin e dhomave ftohese duke garantuar nje temperatore 0-4°C.

Per ftohjen e koridoreve dhe dhomave te ngarkeses, ato te ndarjes se mishit, perdoret ajer i kondicionuar.

Agjenti ftohes i perdorur ne kompresore eshte freoni me indeksin R 22 ndersa si agjent transportues i ftohtesise, perdoret perzjerja e ujit me glikol ne raport te caktuar per te perballuar shkallen e ftohtesise.

Brenda magazinave dhe ambienteve qe ftohen jane vendosur instrumenta kontrolli te temperatures dhe lageshtise relative.

Ftohja e kompresoreve per kondensimin e gazit te nxehte realizohet me ndihmen e ajrit te ftohte.

Veç ftohjes qendrore, ne ambiente te veçanta jane vendosur kompresore autonome, per realizimin e temperaturava akoma me te uleta.

STALLAT

Ne hyrje te impiantit, perkrahe rruges se automjeteve, ne te ashtequajturen “zone e ndotur” jane te vendosura stallat per pranimin e kafsheve qe vijne per tu therur.




Fig. Automjetet e transportit te kafsheve dhe stallat e pritjes dhe trajtimit

Automjetet jane te konstruktura me plane te pjerreta qe sigurojne mos demtimin e kafsheve gjate zbarkimit te tyre nga automjeti direkt ne stalle.

Stallat ne vehtevehte jane te paisura me dushe per larjen paraprake te kafsheve.

Pas çdo operacioni shkarkimi te automjeteve, ato kalojne per larje dhe dizifektim para largimit nga impianti.

PERSHKRIMI TEKNOLOGJIK I PROÇESIT

Çdo lloj bagëtie ose gjedhi ka mënyrën e tij specifike të trajtimit teknologjik gjatë procesit të therjes. Ky proces fillon me pranimin e kafshëve në stallat e thertoresh dhe pushimin para therjes.

Pranimi dhe procesi i pushimit (urisë) Mbas pranimit kafshët qëndrojnë në paratherje për tu çlodhur dhe i nënshtrohen procesit të urisë. Koha e qëndrimit në paratherje për bagëtitë e trasha është 24-36 orë në varësi të mundimit fizik, për bagëtitë e imëta është 12-24 orë në varësi të moshës, peshës trupore dhe mundimit fizik që kanë kryer. Bagëtisë në periudhën e urisë i ndërpritet ushqimi dhe i jepet ujë i cili ndërpritet 2-3 orë para therjes. Pushimi dhe periudha e urisë bëhet për shumë arsye teknologjike: shmangien e mundimit fizik dhe ngacmimeve nervore që ndikojnë në procesin e çgjakësimit, zvogëlimin e përmbajtjes së ushqimit në aparatit tretës gjë që ndikon në uljen e ngarkesës mikrobiale, lehtëson proceset e mëtejshme të therjes si heqja e lëkurës, nxjerrja e organeve të brendshme etj.



Fig. Paratherja per bagetite e imtat dhe te trashat

Gjatë trullësjes nuk duhet që kafsha të humb funksionin e zemrës dhe organeve të frymëmarrjes pasi pengohet procesi i çgjakësimit duke bërë që të ulet cilësia e mishit. Trullësja kryhet me anën e goditjes me shok elektrik. Fillimisht kafsha nepermjet nje koridori drejtohet ne vend trullösje. Aty i hidhet pak uje ne koke ne menyre qe te realizohet nje qark i plote elektrik per te bere trullösjen sa me eficente.

Proçesi i ç'gjakezimit. Mbas trullösjes kryhet çgjakësimi, ky proces kryhet duke bërë prerjen e venës dhe atë të arteries kryesore. Qëllimi i çgjakësimit është largimi i gjakut, pasi qëndrimi i tij në mish bëhet burim prishje, pasi dihet që gjaku është një mjedis shumë i përshtatshëm për mikroorganizmat. Çgjakësimi kryhet në dy pozicione në pozicion horizontal dhe vertikal, më i përshtatshëm është ai vertikal pasi arrihet një shkallë çgjakësimi më e mirë.

Koha e çgjakësimit është e ndryshme në varësi të llojit të bagëtisë. Për gjedhin ajo nuk duhet të jetë më pak se 6 minuta dhe jo më tepër se 20 minuta. Mbajtja për një kohë më të gjatë do të shkaktonte largimin e një sasive të lartë gjaku, i cili do të sillte si pasojë çngjyrimin e mishit duke ulur intensitetin e ngjyrës.

Gjaku i rrjedhur gjate ketij procesi kalon nepermjet pusetes mbledhese per ne sektorin e pastrimit te ujrave teknologjike.

Mbas çgjakësimit bëhet heqja e kokës dhe heqja e lëkurës ne menyre te mekanizuar. Trupi bagetise tashme i çgjakesuar nepermjet sistemit levizes me shina kalon ne kete proces i cili kryhet ne mynyre manual nga specialistet perkates.

Lekurat e hequra grumbullohen ne nje konteniere te veçante dhe me pas behet kriposja e tyre ne ambjentet e grumbullimit te lekurave. Edhe kokat gjithashtu futen ne konteniere te veçante dhe dergohen per larje dhe ambllazhim per tregetim.

Proçesi vazhdon me largimin dhe pastrimin e karkases nga organet e brendshme. Gjate ketij procesi hapet kaviteti abdominal i kafsheve dhe ai torakal dhe hiqen zorret, plendesi, zemra mushkerite, melçite shperetka etj. Pjeset e pa perdoreshme mblidhen ne nje konteniere per tu derguar per asgjesim

Më pas bëhet sharrimi i trupave kjo bëhet me qëllim që të lehtësohet transporti i trupave të therur, të lehtësohen dhe të përshpejtohen proceset e ftohjes, ngrirjes dhe sistemimi e tyre gjatë ruajtjes së tyre në gjendje të ngrirë.

Më pas realizohet kontrolli veterinar. Ky kontroll konsiston në kontrollin e mishit të bagëtive të cilat mund të jenë të prekura nga sëmundje të ndryshme si të mëlçisë, zemrës mushkërive dhe vetë mishit. Po ashtu kur mishi gjatë kontrollit del se është i prekur nga sëmundje veçohet dhe sipas vlerësimit të mjekut dërgohet për trajtime të mëvonshme të veçanta. Pas kontrollit veterinar mishi vulozet nga mjeku veterinar dhe vlerësohet nga teknologu cilësia e mishit, lloji i tij sipas standardit në fuqi dhe jepet destinacioni i duhur. Trupave të therur u bëhet edhe tualeti i cili është dy llojesh i njomë dhe i thatë.

Tualeti i thatë konsiston në largimin e dhjamërave të barkut, pjesëve të gjakosura, gjëndrave të papërdorshme si ushqim, absceset, mbeturinat e mishit të diafragmës, mbetje të trakesë dhe të ezofagut etj.

Largimi i dhjavit nga mishit behet me nje makineri te posacme e cila e largon dhjavin e tepert nga mishit dhe me teje futjen e tije ne nje kontenier.

Tualeti njomë bëhet gjithmonë mbrapa atij të thatë, ai kryhet me anë të dushit ku mishit lahet me ujë të freskët dhe të ftohtë me qëllim që të largohen të gjitha papastërtitë dhe gjakrat në sipërfaqe

Tualeti i njomë gjithashtu ka për qëllim uljen e temperaturës së mishit të porsatherur. Kujdes i veçante tregohet mbas tualetit të njomë mbasi bëhet tharja me leckë të thatë ose me ventilim sepse lagështia që ngelet rrezikon prishjen e mishit

Maturimi i mishit pas therjes Mbas përfundimit të therjes karkasa duhet të qëndrojë patjetër në temperaturën e ambientit në vende të caktuara për rreth 2-6 orë për arsye teknologjike si: të bëhet kullimi i mishit nga mbetjetë gjakut, të ulet temperature e mishit në temperaturën e ambientit, të kemi ulje të pH, që të jetë i gatshëm për proces ftohje sepse mishit i porsa therur nuk lejohet të futet direkt në frigorifer pasi ka ndryshim të madh temperaturash dhe si pasojë e avullimit kemi humbje të ujit në mish, dhe mishit do të jargoset dhe ka precedence për prishje.

Pas maturimit të mishit ai dergohet në frigorifer për tu ruajtur dhe për tu marrë me teje për tu ndarë dhe perpunuar dhe beret e gatshëm për treg. Janë disa procese që shoqerojnë trajtimin e mishit për treg, sektore që perpunojnë mishin duke filluar nga heqja e kockave deri në perpunimin e tije sipas ndarjeve anatomike.



Fig. Pamje nga proceset e perpunimit te mishit

TEKNOLLOJIA E PERPUNIMIT TE UJRAVE TEKNOLOGJIKE

Impianti që është vendosur për trajtimin e ujrave të shkarkimit është i tipit biologjik me llumra aktive nga ku procesi vjen nga punimi i mikroorganizmave aerobike të cilat degradojnë permbajtjen organike prezente në ujin që do të shkarkohet. Teknologjia zhvillohet dhe realizohet në një reaktor me cilet të pa ndërprerë (**Reaktor Batch** ose **SBR**).

Reaktori Batch ose SBR karakterizohet nga fakti se dy funksionet kryesore të impiantit me llumrat aktive, oksidimi biologjik dhe pastrimi përfundimtarë që realizohen në të njëjtin basen. Impianti realizohet sipas teknologjisë SBR dhe janë veçanërisht adapte për trajtimin e shkarkimeve industriale në të cilat me ndryshime minimale të ngarkimit në mynyre hidraulike, organiket që karakterizojnë efluentet legale industriale largohen me ritme operative në repartin e punës. Në një sistem SBR cikli i trajtimit është shpërndarë në 4 perioda kohore specifike të cilat i korrespondojnë fazave të ndryshme të procesit.

Gjatë gjithë proceseve të punës në thertore konsumohen sasi të mëdha uji që kryesisht përdoren për realizimin e proceseve teknologjike dhe larjeve të ambienteve të punës pas çdo procesi

I gjithë sektori i thertores është i kompletuar me sistemet e kanalizimit dhe drenazhimit të këtyre ujrave që dalin qoftë gjatë realizimit teknologjik apo larjeve të sektoreve, të cilat tashmë të ndotur me të gjithë komponentet organike që dalin gjatë procesit në thertore, grumbullohen në një basen të veçantë nën

tokesore per te kaluar me teje ne perpunim dhe pastrim te ketyre ujrave ne impiantin e ngritur per kete qellim






Fig.Pamje nga pusetat, kanalizimet e brendeshme si dhe vend grumbullimi i ujrave te ndotur

Ujerat e ndotur te grumbulluara ne basenin nen tokesore, kalohen ne procesin e hollimit me uje thithen me ana e nje pompe dhe kalohen ne nje paisje ndarese (grile) e cila largon mbeturinat e ngurta nga ujerat e ndotur

SKEMA PRINCIPIALE E FUNKSJONIMIT TE IMPIANTIT TE PASTRIMIT TE UJIT



LLUMI I NDARE



Me teje ujrata e ndotura dhe te holluara kalohen ne basenin e ngoprjes me ajer ku realizohet oksidimi biologjik i ujrave te ndotur. Nderkohe te gjitha komponimet organike sedimentojne ne trajte te llumrave te oksiduar biologjikisht dhe ketyre llumrave te sedimentuar kalohet ne procesin e flotacionit.

Ne kete proces ne mynyre automatike behet dozimi i kimikateve poliklorur alumini qe ka veti koagulante, hidroksid natriumi dhe Rimax 21 me baze rezinash. Keto kimikate realizojne ngurtesimin e llumrave te oksiduar dhe me ane te bulbezimit te ajrit formohen kropuskule qe dalin ne siperfaqe dhe qe me ane te disa lopatave largohen nga uji per te kaluar ne procesin e ntrashjes se tyre, proces qe realizohet ne nje basen me volum prej 40 m³.

Uji i dale nga procesi i trashjes riciklohet perseri ne sektorin e akumulimit te ajrit.

Uji i dale nga proçesi flotacionit i nenshtrohet fillimisht nje proçesi hollimi dhe me teje proçesit te SBR. Llumrat e nentrashur tashme largohen me ane te nje boti special per kompostim se bashku me mbetjet e tjera te ngurta organike.

Gjate proçesit te SBR realizohet pastrimi me i thelluar i ujit duke u bazuar ne futjen e llumit aktiv. Pak a shume kemi te bejme perseri me nje proçes se oksidimit biologjik te mbetjeve qe shoqerojne ujin qe ka kaluar fazen e pare te pastrimit.

Avantezhet e reaktorit SBR konsistojne ne;

- Reaktore veçanerisht te pershtatshem per trajtimin e mbetjeve me origjine industriale
- SBR nuk paraqisin probleme persa i takon preferencave (qarkullimi shkurter) dhe qe faza e sedimentimit behet e shpejte me ngjitje zero, dhe qe garanton nje rritje eficente te separimit.
- Zgjatja e fazes se sedimentimit mund te jete e ndryshme ne funksjon te karakteristikave te sedimentimit te llumit. Siperfaqja e sedimentimit eshte e njejte me siperfaqen e brendeshme te reaktorit normalisht ngarkesa e qendrushme per njesi te siperfaqes dhe keshtu ekstremisht e reduktuar.
- Fleksibilitet te funksjonimit te fazes se reaksjonit e cila duhet te jete e modifikuar lehtesisht ne vartesi te kohes te fortesimit dhe modalitetit te percimit. Ne fakt duhet te jete drejtuar ne ambjente te ndryshme qe lejojne realizimin e largimit te permbajtieve karbonioze, te azotit (nitrifikim/denitrifikim) dhe te fosforit.
- Alternim te kushteve te proçesit dhe rendesine ekstremale te perfundimit te seleksjonimit te nje komuniteti mikrobik me karakteristika te mira sedimentimi. Dhe ne se nuk eshte e mundur te theksohet me siguri absolute qe konditat e prerjes proçesit jane te disfavoreshmen ne te gjitha rastet, rritja e bakterieve ne trajte fijesh egziston e percaktuar eksperimentalisht duke demonstruar rritje te sedimentimit dhe rezistencen ndaj goditjeve te llumit aktiv te reaktorit SBR.
- Mungesa e pompes per riciklimin e llumit; keto te fundit jane prezente vetem ne reaktor dhe per kete pranohet nje fitim neto ne fund te sedimentimit volumor.
- Eficence e oksigjenimit shume te larte sepse faza e reaksjonit ka filluar me koncentrim te oksigjenit te nisur nga zero dhe mundesine e efecenses te ndryshimit te barabarte me 30%.

Uji dale nga nga reaktori SBR tashme i paster drenazhohet per ne kanal ndersa llumrat nje pjese ruhet per riciklim dhe pjesa tjetere shkarkohet bashke me llumin qe del nga proçesi i flotacionit.

Lendet e para

Lenda e pare qe perdoret ne thertore jane kryesisht bagetite e imeta dhe te trasha te cilat sigurohen nga tregu brendeshem qe perfaqesohet nga fermat e mbareshtimit te bagetive apo persona individe kryesisht nga fshatrat qe dorezojne per shitje bagetite.

Nderkohe ne impiantin e pastrimit te ujrave teknologjik si lende te para jane ujrat teknologjike qe vijne nga te gjitha proçeset e punes se thertores si dhe kimikatet qe perdoren per trajtimin e ketyre ujrave dhe qe jane Poliklorur Alumini (PAK), Hidroksid Natriumi(NaOH), Solucion antishkume ne emulsjon i njohur me emerin tregetare RIMAX 61 kimikate keto qe kryesisht sigurohen nga importi.

Disa te dhena per keto lende te para paraqiten ne tabelen e me poshteme

Hidroksid Natriumi	Leng i tejdkushem	Densiteti 1,5gr/cm ³	NaOH ne % 50	Na ₂ CO ₃ ne % 0,3	NaCL mg/kg 100
Poliklorur alumini	Leng i verdhe	Densiteti ne 20°C 1.37 gr/ml	Titulli Al ₂ O ₃ % 16-18	Titulli AL % 9.0	Koagulant inorganik
Rimax 61	Emulsjon ne trajte lengu	Me permbajtje rezinash			

Bagetite e tasha dhe te imeta	Bageti te gjalla	Derra	Te trasha	Te imta	
Mishi bagetive per perpunim	Mish i freske	Mish nga derrat	Mish nga bagetite e trasha	Mish nga bagetite e imet	

Lendet ndihmese:

Adezive per mishin, ereza per mishin, qeska plasike per amballazhim, kuti kartoni per amballazhim Energjia elektrike merret nga rrjeti kryesor i energjise elektrike te zones perreth sipas kontrates te bere nga vet pronari i kesaj firme me CEZ.

Uji i cili merret nga 2 puse brenda territorit te impiantit te hapura vete nga kompania.

Menaxhimi i Instalimit

Menaxhimi i instalimit behet nga nje staf i kualifikuar dhe trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar aktivitetin e impiantit te thertores, perpunimit te mishit, magazinimit frigoriferik dhe atij te perpunimit dhe pastrimit te ujrave teknologjike, per te cilin shoqeria "TONA ALB " operon ne tregun rajonal. Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj shoqeria konform te gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, eshte organizuar puna ne menyre te tille qe te funksionojne ne formen e nje organograme per realizimin sa me eficient dhe te sukseshem, e cila tregon menyren e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe pergjegjesive te secilit. Përbërësit kryesorë të këtij programit per menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

Informacion i përgjithshëm;

Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;

Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Çertifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.

Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria

Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.

Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të licensuara

Zhurmat do të jenë të përkoshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;

Funksionimi;

Arsyet për propozimin e masave zbutëse;

Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendim marrja;

Trajnime specifike;

Monitorimi i cilësisë ujrave;

Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;

Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;

Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;

Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;

Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;

Kërkesat e mjeteve që do t'ju kryhet shërbimi;

Menaxhimi i prodhimit Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerive nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marre keto masa:

Përreth impiantit të thertores ruhet distance e sigurisë prej 1.5 m, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik të impiantit dhe drejtuesi i panelit tek kontrollit.

Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese.

Eshte instaluar sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato kane) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, ujrato pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në rrjetin e kryesor të kanalizimeve të zones , këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme pasi fillimisht i nenshtrohen procesit të trajtimit për pastrim në impiantitn e perpunimit të ujrave.

Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat janë: lende të aballazheve, letra-kartona, qelqë, si dhe lende organike të prodhuara nga punonjesit ku keto mbetje depozitohen në vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku janë vendosur kosha selektive.

Mbetjet e ngurta urbane të prodhuara, depozitohen në kosha brenda territorit të shoqërisë me volum 1 m³ prej ku me pas merren nga mjetet e pastrimit të komunës, për të dërguar në venddepozitim të caktuar prej tyre. Sasia e mbetjeve urbane të gjeneruara nga punonjesit është 0.4kg/dite për person. Rrjeti elektrik që furnizon impiantin me energji elektike është i tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qendrore të shpërndarjes e cila është e sigurtuar me celësin e sigurisë, për çfardo lloj avarie të mundshme.

Lënda e pare në rastin konkret bagetite të gjalla transportohen me anën e mjeteve specifike të transportit të modifikuar enkas për këto qëllime. Furnizimi me bageti të gjalla bëhet periodikisht, gjatë gjithë kohës së funksionimit të impiantit.

Pajisjet e reja janë me të avancuara dhe një sërë veprimesh i kanë të automatizuara duke shmangur kështu nderhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, për veç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos nderhyrjen në makineri gjatë punës, stakimit të energjisë para fillimit të kontrollit apo mirëmbajtjes e remontit të tyre, etj.

Produkti përfundimtar me përberje mishi kalohet në frigorifere dhe me teje ngarkohet në makina frigoriferike për të shpërndarë në rrjetin konsumativ sipas kërkesave.

Lëndët e para dhe materialet ndihmëse

Lenda e pare në rastin konkret bageti të gjalla të imeta apo të trasha, blihet e gjitha nga subjekte të tjera të perfaqesuar nga blektore apo fermere të lincensuara për mbareshtimin e tyre. Me lenden e pare të blerë nënkuptojmë bagetite të trasha si dema, derra, lope vica dhe bageti të imeta si dele, dhi, qengja, keca etj.. Në rastin që merret nga pusët e hapura nga subjekti për qëllime të procesit të punës. Mishi i prodhuar nga bagetite të trasha apo të imeta sipas klasave të ndryshme do të jenë i cilesis se larte dhe konform kushteve të cilesis per keto produkte. Bagetite që do të blihen do të jenë konform kërkesave tekniko veterinarë dhe do të blihen nga subjekte të tjera që merren me mbareshtimin e tyre. Pasi transportohen me mjete të posaçme vendosen në stallat e subjektit ku bëhet qetesimi dhe pastrimi i tyre .

- **Menaxhimi i lëndëve të para**- Sistemi i transportit: Transportimi i lëndëve të para, në rastin konkret të bagetive të imeta e të trasha, të cilat luajnë një rol kyç për operimin normal dhe brenda normave të sigurimit teknik, të proceseve që realizohen në objektin ku është instaluar impianti i thertores dhe ai i trajtimit dhe

pastrimit te ujrave teknologjike . Transporti sigurohet nga mjetet e shoqërisë “TONA ALB”, te cilat jane ne gjendje shum te mire funksionale. Furnizimi me bageti bëhet periodikisht sipas kërkesave dhe funksionimit të impiantit. Mjetet e transportit janë të kolauduara dhe të mbuluara, me qëllim shmangien e rrezikut për renies apo demtim të bagetive gjatë transportit dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpejtësia e lëvizjes së mjeteve është brenda rregulloreve dhe kriterëve të transportit të materialeve, në varësi të materialit që transporton.

Dorëzimi i Bagetive: Mjetet e transportit regjistrohen para hyrjes në territorin e objektit. Bëhet verifikimi i bagetive që transportohet brenda tyre, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe drejtuesi teknik i operacioneve brenda ne objektin e “TONA ALB” nëse ka mospërputhje të bagetive që janë porositur dhe atyre që kan ardhur në objekt. Mjetet e transportit parkohen brenda objektit në vendin e caktuar prej shoqërisë, duke ruajtur të gjitha distancat dhe masat e sigurisë, për operimin normal të punës për shkarkimin e ngarkesës. Shkarkimi i bagetive realizohet duke ulur planin e pjerret nga vete automjetet respektivisht ne impiantet perkates (stalat e bagetive), nën kujdesin e vecantë të drejtuesit teknik dhe masa të mëdha sigurie . Pas shkarkimit te bagetive, bëhet edhe një here verifikimi i sasisë së marrë në dorëzim, nëse kemi perputhje midis dokumentit te shoqerimit dhe gjendjes faktike. Drejtuesi teknik sigurohet që stallat e vendosjes se bagetive, jane te sigurta, për ruajtjen ne kushtet e kerkuara.

Transporti i brëndshëm: Transporti i brëndshëm i bagetive per ne vend therje behet me dore, ndersa proceset e tjera realizohen ne vendet e percaktuara sipas teknologjise qe fillon me trulllosjen elektrike, egjakosjen, heqien e lekures dhe kokes ,nxjerrja organeve te brendeshme,ndarjes ne mes te mishit, larjes se tij dhe me teje prerjes dhe paketimit te tije deri ne futjen ne frigorifer. Punonjesit qe operojne ne keto operacione jane te paisur me te gjitha mjetet sipas operaioneve si dhe veshjeve te punes . transporti nga nje vend pune ne nje tjetër eshte i automatizuar duke u realizuar nepermjet hekurudhave ajrore te transportit te produktit. Keto mjetete të posacme drejtohen nga punonjësit e subjektit, nën kujdesin e drejtuesit teknik, i cili monitoron dhe drejton funksionimin e operacioneve dhe proceseve për shfrytëzimin sa më eficient të teknikes dhe instalimit me qellim arritjen e produkti perfundimtar sipas kerkesave te klienteve dhe standarteve te kerkuara per te tilla procese pune.

Organizimi i punes dhe fuqia punetore: Puna brenda në objekt është e ndarë qartë, dhe secili prej punonjëseve realizon ato procese pune për të cilat ai është ngarkuar nga përfaqësuesi i shoqërisë, procesi i prodhimit është i automatizuar dhe monitorohet nga drejtuesit teknik i impiantit te theroresli. Në të punojne rreth 100 punonjes(se bashku me shoferet), ne varesi te kerkesave per produktet e mishit nga shoqeri dhe klient te ndryshem. Regjimi i punës eshte me 1 turn kur shoqëria do ë punojë me kapacitet të plotë. Punonjësit e punësuar kane eksperiencë shume vjecare në kryerjen e proceseve të ndryshme

Identifikimi i ndikimeve ne mjedis dhe masat per minimizimin e tyre

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive te impiantit te thertores dhe atij te perpunimit dhe pastrimit te ujrave teknologjike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte. Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme nga ky raport i ndikimeve në mjedis. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiencës nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me therjen dhe perpunimin e mishit gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Çeshtjet e mjedisit të lidhura me vendosjen në stall të bagetive, në llogjikën e ciklit të jetës së produktit përfshijne:

- Praktika të qëndrueshme në menaxhimin e bagetive gjatë qetesimit dhe pastrimit të tyre, përdorimin sa më eficient të tyre gjatë proceseve të metejeshme, duke u kujdesur për klasifikimin e mbetjeve dhe ndarjen e tyre.

- Praktika të qëndrueshme në reduktimin e emetimeve në ajër nga procesi i vendosjes në stall të bagetive, si dhe larjen e vazhdueshme të ambjentëve të stalles.

- Shkarkimet në ujëra

Shkarkimet në ujëra vijne nga:

a) Mbetjet e lengshme të Linjës përpunimit mishit (Thertore) veçanërisht (gjaku)

b) Mbetje, ose derdhje të ushqimit në trajtë të lengshme për bagetinë që ruhet në stalla në pritje për tu therrur

c) Pastrimi i ambjentit të Linjës përpunimit mishit (Thertore), larja e enëve dhe makinerive, etj.

d) Ujërat e përdorura për qëllime sanitare. Lidhur me ujërat që vijnë nga përdorimi i sanitare, ato nuk duhet të perzihen me ujërat industriale, por duhet të kalojnë në sisteme kanalizimi dhe të lidhen me kolektorin e zonës. Gjithashtu ujërat e përdorura, mbas proceseve të ndarjes në dekantor duhet të kalojnë në sisteme të mbyllur me riqarkullim të impiantit të pastrimit, deri në arritjen e cilesive për tu shkarkuar në mjedis. Duke marrë në konsideratë respektimin e kushteve teknike në këto objekte, mundësitë e ndotjes nga rastet e emergjencave janë të rralla. Ujërat e pastrimit të ambjentit dhe mbetjeve, duhet të trajtohen në vasken e dekantimit paraprakisht dhe të trajtohen biologjikisht e kimikisht, para se të shkarkohen në mjedisin ujor të zonës. Nuk duhet të shkarkohen në mjedisin ujor të zonës pa u trajtuar paraprakisht. Ndikimi i këtij aktiviteti në ujëra nëse nuk kryhet një trajtim biologjik dhe kimik i ujërave të dalë nga aktiviteti i stalles, do të vlerësohet me ndikim domethenës në mjedisin e zonës. Përshkrimi i proceseve, sipas relacionit të paraqitur dhe deklaratimit të investitorit, nuk përfshinë përdorimin e ujit. Larja e pastrimit të ambjentit të makinerive, mund të përbejë një potencial ndotjeje, pasi lenda organike mund të rrisë ndotjen bakteriale të ujit të përdorur e si rrjedhojë edhe të mjedisit ujor prites.

Funksionimi normal i impiantit të trajtimit dhe pastrimit të ujërave minimizon në maksimum ndikimin e ujërave të shkarkuara në mjedis.

Ujërat teknologjike, mbas proceseve të grumbullimit të vasken, me anën e pompave zhytëse kalojnë në impiantin e përpunimit të ujërave ku trajtohen me metoda biologjike (sisteme aerobike), kimike (duke trajtuar me kimikate si poliklorur alumini, hidroksid natriumi etj) dhe fizike (ndarje me flotacion). Të gjithë këto procese realizohen me një program automatik dhe në sisteme të mbyllura. Me tëje, ujërat lihen në qetësi ku bëhet ndarja dhe trashja e llumit, i cili me tëje transportohet me një botë të posaçëm për në vend grupsje për kompostim së bashku me mbetjet e tjera organike që dalin gjatë procesit në dekantor kalojnë në sisteme të mbyllur me riqarkullim, ose pas dekantimit të tyre nga lenda e ngurte në pezulli, shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zonës. Në asnjë rast nuk shkarkohen në mjedis ujëra sipërfaqësore, në gjendjen fillestare të tyre, pa kaluar në sistemin e cili pasi futet në një botë të posaçëm, grupsjet për kompostim së bashku me mbetje të tjera organike që dalin gjatë procesit të therrjes.

- **Ndotja e tokës** Ndotja e tokës si rezultat i aktivitetit të Linjës përpunimit mishit (Thertore), mund të ndodhë në rast se nuk menaxhohen mbetjet e ngurta të fekaleve ose përdorimi i tyre si pleh organik. Kështu, një sasi e vogël e tij, mund edhe të aplikohet në bujqësi, por në sasi të reduktuara. Gjithashtu depozitimi në vende të pa autorizuara, i këtyre mbetjeve mund të shkaktojë ndotje të tokës dhe të mjedisit ujor sipërfaqësor e nëntokësor të zonës.

Ndotja e tokës mund të ndodhë dhe si rezultat i rrjedhjeve të ndryshme gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të automjeteve apo në rast të emergjencave të mundshme nga avarite në sistemin; Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit është i mbyllur dhe mundësitë e derdhjeve në mjedis të lëndës gjatë procesit nuk egzistojnë. Sistemi i terminalit të shkarkimit është i shtruar me beton dhe si rrjedhojë nuk do të kemi ndotje

te tokes, ne raste te derdhjes se lendes ne mjedis. Kamionet jane special dhe sherbejne vetem per transport te bagetive. Automjetet dhe makinerite jane te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te mbetura nga bagetite qe transportojne. Shkarkimi ne toke i elementeve te demshem per mjedisin, shkakton ndotje serioze ne mjedis, ndaj rekomandohet qe aktivitetet te jene te paisura me masa mbrojtese dhe te shtrojne siperfaqet ku ato veprojne. Ndotja e tokes, ndikon edhe ne ndotjen e ujerave nentokesore.

- **Ndotja e ajrit** . Ndotja e ajrit mund te ndikohet gjate ushtrimit te ketij aktiviteti ne mjedisin e zones. Stalla e mbajtjes se bagetive te imta dhe gjedhit ne prithe te therjes dhe mbetjet organike te gjakut qe del nga therja dhe e fekaleve te tyre, çlirojne gaz(amonjak) dhe arome te pa kendshme. Aroma e ketij gazi, mund te perhapen deri ne disa qindra metra perreth zones. Keshtu, nese ka banesa ne distancen me te afert se 500m mund te arrije ndikimi deri ne kete distance, ndonese ne nivele te uleta e jo shqetesuese. Nje faktor tjetër ne perhapjen e ketij gazi ne mjedisin e zones eshte edhe drejtimi i eres ne rajonin ku zhvillohet ky aktivitet dhe qendrat e banuara me te aferta ne kete drejtim. Keshtu, nese subjekti nuk parashikon pastrimin e stallave per mos clirimin e ketij gazi dhe aromes se madhe duke e menaxhuar ate, siç duhet atehere mund te shfaqen ndikime te rëndësishme ne mjedisin human te zones.

Gjate ushtrimit te procesit teknologjik nuk ka ndotje te ajrit pasi nuk ka snje burim qe lidhet me ndikimet e ndotjes se ajrit sikunder jane kaldajat qe perdorin lende djegese, procese kimike qe shoqerohen me çlirime te gazit, procese fizike qe shoqerohen me çlirim te pluhurave etj

Zhurmat Ndotja zanore është veçanërisht e rëndë në vendet në zhvillim. Ajo i detyrohet kryesisht trafikut rrugor dhe në zonat dense (të dendura) të trafikut rrugor, nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dB(A). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor “i dukshëm”. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Edhe persa i i perkete **zhurmave**, ato jane te pa ndjeshme dhe vetem ne afersi te linjes se prodhimit deri ne nje distance prej 15 m mund te degjohet ndonje zhurme e vogel kryesisht qe mund te kete burim nga mjetet e transportit por qe nuk kan asnje ndikim ne mjedis dhe jashte rrethimit ato pothuajse jane ne kufinjte me minimale te normave te lejuara.

Mbeturinat e ngurta: Aktiviteti human, mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones. Nga aktiviteti vleresohet te kete mbetje te ngurta nga ambalazhet e produktit ushqimor, si plastmas, leter, karton paleta druri, etj. Ndersa mbetjet e ngurta te fekaleve, perbejne nje potencial ndotjeje te mjedisit, e si rrjedhoje duhet te menaxhohen ne menyre profesionale nga specialist te mirefillte. Politikat për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimi i infrastrukturës institucionale, forcimi i rolit dhe bashkëpunimit midis institucioneve qëndrore dhe lokale, ndërgjegjësimi i publikut dhe angazhimi i të gjithë aktorëve të interesuar për administrimin e mbetjeve kanë qenë një nga objektivat më kryesore dhe të rëndësishme të legjislacionit dhe strategjisë kombëtare. Rëndësia e synimi kryesor është zbatimi i plotë i tyre duke filluar me parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, riciklimin, trajtimin e tyre për shfrytëzimin e nxehtësisë apo energjisë për qëllime industriale, shtëpiake etj, dhe depozitimi i tyre në landfill. Një vend të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit tonë dhe direktivave të Bashkimit Europian ka trajtimi dhe shfrytëzimi i mbetjeve industriale. Mbetjet industriale përveç nevojës dhe rëndësisë së riciklimit dhe përdorimit të tyre, kanë vlera ekonomike në shfrytëzimin e energjisë termike të gjeneruar gjatë procesit të incinerimit (djegjes).

Masat zbutese te projektuara te ndikimeve negative gjate procesit te funksionimit.

A. Masat për emetimet në ajër Gjatë fazes së operimit burimet nga të cilat shkaktohen dhe emetohen gaze dhe grimca të ngurta janë : lëvizja e automjeteve . Lënda djegëse e cila do të përdoret nga mjetet dhe automjetet që do të operojnë do të jenë të një cilësie të mirë .

1. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren gjatë fazes së operimit do t'ju jenë kryer serviset teknike të duhura .

2. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren nuk do të jenë të amortizuara të cilat mund të shkaktojnë emetimet e gazeve në nivele të larta në atmosferë.

3. Të realizohet spërkatja e ambjenteve në mënyrë që të reduktohet sasia e pluhurit që mund mund të shkaktohet gjatë lëvizjes së automjeteve.

4. Automjetet përreth objektit të spërkatën me ujë për të shmangur pluhurin.

B. Masat për emetimet në tokë Në baze të analizës së vlersimit të paraqitur më lart , ndikimet në cilësinë e tokës do të hasen vetëm në rast se do të ketë shkaktime aksidentale të derdhjes së lëngjeve perzier me gjakut gjatë thërjes së kafsheve, të ujërave të shkarkimit të Linjes perpunimit mishit (Thertore), të hidrokarbureve të cilat ndikojnë në ndotjen e asaj sipërfaqe . Madhësia e këtij ndikimi do të jetë në varësi të madhësisë së aksidentit . Kompania duhet të aplikojë masa për parandalimin e çdo aksidenti në mjedis .

1. Kompania të përcaktojë një vend të caktuar dhe të pajisur me kosha grumbullimi

2. Çdo lëndë ndihmëse do të magazinohet në kushte optimale në mënyrë që të mos ndodhë asnjë lloj shkarkimi aksidental në tokë.

C. Gjatë perimetrisë së sipërfaqes ku do të operojë kompania të hapen kanale kulluese në mënyrë që të sistemohen ujërat sipërfaqësorë të sheshit dhe të kontrollohet çdo lloj derdhje brenda sipërfaqes së projektit

D. Masat për reduktimin e ndikimeve në ujërat teknologjike dhe sipërfaqësorë Operimi i këtij lloj projekti gjeneron ujëra teknologjik dhe për këtë arsye ato trajtohen me qëllim që të mos ndikojnë në mjedis,

1. Kompania gjatë fazes së operimit të kalojë ujërat teknologjike në impiantin e trajtimit të ujërave dhe ujërat sanitare dhe ujërat e bardha në kanalizimin e ujërave urbane

2. Të sistemojë ujërat sipërfaqësorë të sheshit në të cilin do të operojë .

3. Të mos derdh asnjë lloj mbetje jashtë sipërfaqeve të percaktuara .

E. Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në biodiversitet Siç u analizua në kapitullin e përshkrimit të gjendjes mjedisore , ndikimet në biodiversitet nga zhvillimi i projektit janë në nivele mjaft të moderuara. Me qëllim që ndikimet që mund të shkaktohen nga projekti të qëndrojnë në këto nivele dhe ezaurimin e mundësive për reduktimin e tyre, kompania të zbatojë masa si më poshtë :

1. Rrugët dytësorë dhe e gjithë infrastruktura që do të përdorë subjekti për zbatimin e këtij projekti të spërkatën më në mënyrë periodike për të ulur nivelin e përhapjes së grimcave të ngurta në atmosferë . 2. Ndryshimi i zonës ku do të zhvillohet projekti gjatë natës të projektohet në atë mënyrë që të mos jetë shqetësuese për kafshët e egra .

F. Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në peisazh Për zbutjen e ndikimeve nga prania e projektit në peisazhin natyrorë kompania do të zbatojë këto masa gjatë fazes së operimit:

1. Përreth sheshit të mbillen pemë të larta

2. Mjedisit të mbahet i sistemuar dhe i pastër

3. Të shmang shkaktimin dhe përhapjen e pluhurit në atmosferë

4. Të shmangët grumbullimi i mbetjeve për një kohë të gjatë .

12. Ndikimet e mundshme në mjedis nderkufitare (në se projekti ka natyrë të tillë) Nga funksionimi i Linjes e perpunimit të mishit (Thertore). nuk do të ketë ndikim as të drejta per drejta dhe as të terthoret në mjedis nderkufitare

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë punimeve në ajër, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore në territor , faune dhe florë. Por pikësynimi i studimit mbetet menaxhimi i linjës së trajtimit të ujërave teknologjik.

Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit

Qëllimet e monitorimit mjedisor Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Qëllimi i monitorimit mjedisor për impiantin e thertores dhe atij të

mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Qëllimi i monitorimit mjedisor për impiantin e thertores dhe atij te perpunimit dhe pastrimit te ujrave teknologjike është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Ndikimet me natyre nderkufitare (nese projekti ka natyre te tille). Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime me natyre nderkufitare, zhvillohet brenda territorit te vendit ne Bashkine Korçë

